

# FOL DHE VEPRO



# LIRSHËM

## DEMOKRACIA DHE LIRIA QYTETARE

YLLKA (14), ARGJENDA (15), AGNESA (14), ENDRIT (14), BURHAN (14), VEPRIM (14)



Në këtë punim kemi vizatuar barazinë njerëzore në demokraci

### Ne jemi klasa IX-4 - Sh.F.M.U „Pjetër Bogdani“. Me anë të këtij artikulli, ne do të mundohemi të shfaqim idetë tona mbi demokracinë dhe qytetarinë aktive

Liria është fjala më me vlerë, fjalë e cila në vete përmban një domethënie të madhe. Diçka që ka me të vërtetë kuptim dhe që është shumë e veçantë është liria. Ne kemi provuar shijen e hidhur të mohimit të të drejtave tona. Kemi pasur rast të jemi jo të lumtur dhe shumë të lënduar shpirtërisht. Kemi luftuar për fjalën liri, për këtë fjalë me shkronja të arta dhe tani ne duhet ta shfrytëzojmë rastin të jemi të lirë. Ah, sa mirë të zgjohemi në mëngjes dhe të dëgjojmë cicërrimat e zogjve, të marrim frymë lirshëm, të jetojmë të lumtur dhe të shijojmë shijen e ëmbël të demokracisë. Sof grupi ynë bisedoi për vlerën e demokracisë dhe për prejardhjen e saj. Demokracia rrjedh nga greqishja e vjetër „demos“ që do të thotë *popull* dhe „kratos“ që do të thotë *pushtet*. Demokracia është zbuluar në vitin 507 p.e.s. Kemi lirinë, demokracinë, mënyrën e jetesës më të mirë dhe zgjedhjen tonë për jetë. Sof në Punëtorinë tonë kemi mësuar për qytetarinë aktive të një populli. Qytetari aktive quhet atëherë kur një qytetar merr iniciativa të ndryshme për të ndryshuar një problem ose dukuri që na pengon në lagje apo në shkollë. Njeriu i ka të gjitha të drejtat e barabarta pa dallim feje, race, gjinie apo kombësie. Sipas ligjit ne nuk kemi të drejtë të marrim pjesë në procesin


zgjedhor deri në moshën 18 vjeçare. Zgjedhjen nuk mund të na e imponoj askush. Kemi përmendur se në Kosovë ekziston demokracia përfaqësuese parlamentare, me këtë kuptojmë se përfaqësuesit e shtetit zgjedhen nga vetë populli, të cilët pastaj do të punojnë për të mirën e tyre. Si dhe gjatë Punëtorisë kemi përmendur shembuj se si një qytetar numërohet si qytetar aktiv, varësisht nga iniciativa që ai ndërmerret. Dhe krejt në fund jemi shumë të lumtur që sot kishim mundësinë të ishim pjesë e kësaj Punëtori. Të barabartë në çdo aspekt, lirinë e duam përjetë. Jemi një komb, një tokë, një emër dhe tani që jetojmë të lirë, fjalën „Demokraci“ e themi me zemër.



Autorët e artikullit

# ORGANI MË I LARTË PËRFAQËSUES I VENDIT

LORENT (14), RINA(14), ALTIN (14), ARDIT (15), BELINDA (14), FITESA (14), MELISA(14)



## Këtu mund të gjeni disa informacione rreth Kuvendit të Republikës së Kosovës


Kuvendi është vendi ku miratohen ligje të ndryshme të cilat janë për të mirën e popullit. Kuvendi është organi më i lartë përfaqësues i një shteti. Ky institucion është përfaqësues i popullit sepse në Kuvend janë deputetët të cilët na përfaqësojnë ne. Një ndër funksionet e Kuvendit është edhe funksioni kontrollues, sepse ai e kontrollon punën e Qeverisë.

Brenda Kuvendit kemi edhe komisione të ndryshme në të cilat bëjnë pjesë deputetët. Disa prej komisioneve janë: Komisioni për Arsim, për të Drejtat e Njeriut, etj. Mbledhjet të cilat mbahen në Kuvend quhen seanca plenare. Zakonisht çdo të enjte mbahen këto mbledhje, të cilat drejtohen nga Kryetari i Kuvendit.

Në Kuvend bëjnë pjesë 120 deputetë. 20 deputetë janë nga komunitetet jo shumicë. Deputetët zgjedhen nga vetë populli. Fjala deputet do të thotë përfaqësues. Deputetët kanë të drejtën të propozojnë projektligje, të cilat në qoftëse marrin shumicën e votave bëhen ligje. Personat që kandidojnë për deputetë duhet t'i shpallin para popullit planprogramet e tyre. Nëse marrin votat e mjaftueshme nga populli ata zgjedhen deputet. Pasi që zgjedhen, deputetët duhet ta bëjnë betimin e tyre. Në këtë betim përfshihet mënyra se si deputeti do ta kryejë punën e tij dhe se si duhet të punoj në interes të popullit. Pjesëtarët e Kuvendit na përfaqësojnë edhe jashtë vendit. Ligjet për sjelljen e deputetëve

janë të shkruara në Kushtetutë. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti.

Pra, vendimet që merren në Kuvend ndikojnë për të mirë në jetën tonë dhe për këtë arsye ne duhet të menjdojmë mirë para se t'i zgjedhim përfaqësuesit e vendit tonë.



Kuvendi i Republikës së Kosovës



Gazetarët e demokracisë

# E DREJTA E VOTËS, PËRGJEGJËSI E JONA

LIRIKA (14), RINESA (14), QËNDRIM (14), LEUTRIM (14), ARIANIT (14), ARDIT A. (14), PRANVERA (14)

Për të lexuar se çka janë dhe si funksionojnë zgjedhjet, lexoni më poshtë artikullin e shkruar nga ne

Zgjedhja është koncept që e kemi dëgjuar më parë dhe e dëgjojmë mjaft edhe sot. Por, çfarë janë zgjedhjet? Zgjedhjet janë e drejtë e çdo qytetari mbi moshën 18 vjeçare, për të votuar për njerzit të cilët mendojnë që janë të duhur për udhëheqjen e shtetit.


Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare. Këto zgjedhje zhvillohen njëjtë në mënyrë të fshehtë, por dallojnë nga detyra që udhëheqësit do ta kenë. P.sh. Në shkollë kemi kryetarin e klasës dhe kryetarin e shkollës. Kryetari i klasës zgjedhet përmes votave të nxënësve që janë në atë klasë, ndërsa i shkollës nga përfaqësuesit e të gjithë klasave. Kurse, zgjedhjet lokale bëhen vetëm nga qytetarët e atij qyteti (për kryetarin e tyre), e ato parlamentare nga qytetarët për deputetët. Ky ishte shpjegimi ynë për zgjedhjet.



Demokraci, fjalë që na jep shumë të drejta, por në demokraci kemi edhe përgjegjësi




Vota është përgjegjësi e madhe



Demos-ti na ka mundësuar të kuptojmë më mirë zgjedhjet




Në klasë e kemi zgjedhur kryetarin



Në zgjedhje nuk ka dallim të gjinisë

# NDARJA E UDHËHEQJES

SHQIPRIMI (14), ARJANIT (14), LABINOTI (14), URIMI (13), ENDINA (14), BLENDA (14)



## Fëmijët e klasës IX-4 dëshirojnë t'iu tregojnë për demokracinë dhe ndarjen e pushtetit në këtë sistem

Me fjalën demokraci ne kuptojmë një lloj të pushtetit ku vendimet merren nga populli. Në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese. Kjo i bie që ne, qytetarët e Kosovës i zgjedhim vetë përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues punojnë në Kuvendin e Kosovës. Ky institucion quhet Pushteti Legjislativ, sepse bën dhe miraton ligjet. Ligjet shkruhen në Kushtetutën e Kosovës, që është akti më i lartë legjislativ në Kosovë. Ajo është e mbushur me ligje. Në demokraci pushteti ndahet në tri degë, e ato janë Kuvendi, Qeveria, dhe Gjykata. Kuvendi është Pushteti Legjislativ, Qeveria është Ekzekutive dhe Gjykata është Pushteti Gjyqësor.

Detyra kryesore e Kuvendit është të përfaqësoj qytetarët dhe të kontrolloj Qeverinë duke iu bërë pyetje parlamentare kabinetit të Qeverisë. Qeveria është e zgjedhur nga Kuvendi dhe është organ ekzekutiv. Ne e

quajmë atë ekzekutiv, sepse ajo vendimet e Kuvendit i kthen në veprime . Në Qeveri punojnë Kryeministri dhe ministrat.

Në Pushtetin Gjyqësor bën pjesë Gjykata. Ajo ka për qëllim marrjen e vendimeve në bazë të Kushtetutës. Kemi 4 lloje të Gjykatave në Kosovë: Gjykata Themelore, e Apelit, Supreme dhe ajo Kushtetuese. Arsyeja pse ne mendojmë se pushteti duhet të ndahet është për shkak se punët duhen të ndahen në mënyrë të barabartë. Me to, duhet të ndahen edhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve. Kjo ndarje e bën punën më të lehtë për këto institucione, sepse krijon balancim të fuqive dhe i lejon ato të kontrollojnë punën e njëra-tjetrës.

Liria është gjithçka për ne, dhe ajo na garantohet duke u ndarë këto organe demokratike. Pushtetin e kemi ne, dhe ne i marrim vendimet për veten tonë. Ne e duam Kosovën demokratike, sepse për të punojmë dhe jetojmë.



Gazetarët e shkollës „Pjetër Bogdani“



Ndarja e pushtetit sipas nesh



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-4  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë